

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 2

Kodi: 010

HAP PAS HAPI

Trajnim për shkollë fillore

Tipi i programit: Themelor

Hyrje

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), që nga viti 2002, ka ofruar pakon e programeve Hap pas Hapi. Deri më tani, një numër i madh i edukatorëve dhe mësimeve janë përfshirë në këtë program, i cili ka për qëllim promovimin e mësimeve me fëmijën në qendër. Programet e trajnimit Hap pas Hapi pos që janë zhvilluar për të kontribuar në edukimin në fëmijërinë e hershme, janë po ashtu të zhvilluara për të kontribuar edhe në arsimin fillor. Programi Hap pas hapi ofrohet për të mbështetur zhvillimin profesional të mësimeve sipas specifikave të secilit nivel. Qasja Hap pas Hapi e trajton klasën si një komunitet të nxënësve, ku nxënësit angazhohen në mënyrë aktive në procesin mësimor, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, marrin përgjegjësi për të nxënësit e tyre dhe zhvillojnë aftësi akademike, sociale dhe emocionale. Në këtë mënyrë, mësimeve ofrohet të krijojnë mjedise mësimore që mbështesin pjesëmarrjen aktive, respektimin e diversitetit dhe zhvillimin e plotë të çdo nxënësi.

Hartues të moduleve të trajnimit janë OSF – Fondacioni për Shoqëri të Hapur dhe Universiteti Georgetown në Washington, DC. Në Kosovë, programi fillimisht është ofruar nga KFOS – Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, ndërsa që nga viti 2002 licenca për përdorimin e programit Hap pas Hapi i është transferuar KEC-it.

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e *koncepteve* të përgjithshme *filozofike* dhe bazën teorike të *programit me fëmijën në qendër*;
- Njohjen e *praktikave të përshtatshme zhvillimore* që kanë në fokus parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale;
- Aftësi për organizimin e *mësimit të individualizuar*, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor;
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë *frymën demokratike në klasë*;
- Aftësi për *organizimin e mësimit bashkëpunues* që nxit bashkëpunim të hapur dhe të përgjigjshëm;
- Aftësi për *planifikimin e mësimit të integruar dhe mësimin tematik* me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimnxënies dhe mësimeve;
- Shkathtësi për *vëzhgimin* e fëmijës gjatë procesit të mësimeve dhe mësimnxënies dhe *vlerësimin* e efekteve të punës në klasë;

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 2

- Aftësi për *aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies* në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore;
- Ide për krijimin e një *ambienti stimulues për mësimnxënie aktive*;
- Njohuri për *përfshirjen e familjes* në realizimin e programit me qëllim të krijimit të mundësive për zhvillim holistik të fëmijëve.

Përmbajtja e trajnimit

Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm i metodologjisë me fëmijën në qendër, individualizimi, rregullimi i klasës me fëmijën në qendër, materialet në klasë, të mësuarit përmes lojës, integrimi, roli i mësuesit/mësueses në klasën me fëmijën në qendër, planifikimi, takimi i mëngjesit, mësimi tematik I, mësimi tematik II, vëzhgimi, dokumentimi, lexim – shkrim I, lexim – shkrim II, matematikë, shkencë, vlerësimi, arti, loja dramatike, përfshirja e familjes.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet mësimdhënësve të shkollave fillore, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi fillestar për edukatorë realizohet me anë të një trajnimit 5-ditor dhe punës praktike në klasë që përfshin gjithsej 40 orë. Nga 40 orë trajnimit, 30 orë do të organizohen përmes trajnimit të drejtpërdrejt, ndërsa 10 orë do të jenë detyra / punë praktike të cilat do të zbatohen në klasë. Me qëllim që puna të përcillet në vazhdimësi dhe të punohet sa më shumë në ngritje të cilësisë të punës parashihen monitorime në klasë, kur mundësohet realizimi i tyre.

Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 40 orë (30 orë trajnimit si dhe 10 orë zhvillimi përmes punës në shkollë).

Kriteret për certifikim janë:

- Pjesëmarrja aktive në trajnim, së paku në 90% të kohëzgjatjes së trajnimit; dhe
- Dokumentimi i punës praktike në klasë:
 - Dëshmi të përmbushjes së obligimeve në klasë, ku pjesëmarrësit obligohen të dërgojnë planet e punës dhe dëshmitë e rregullimit të ambientit sipas qendrave mësimore, të cilat realizohen brenda 3 javëve pas përfundimit të trajnimit.